

**FEDERATA E BOKSIT  
E KOSOVËS**



**BOXING FEDERATION  
OF KOSOVA**

Tel/Fax: +383 38 247 578; Mob: +383 44 112824,44 208 215 E-mail: [fboxk@hotmail.com](mailto:fboxk@hotmail.com)  
Adress: Str. Agim Ramadani no: 43, House of Sport I floor no3, 10000 Pristina, Kosova  
NLB Bank No: 1701001010850503

Në bazë të nenit 30 nënpika 7 e Statutit të Federatës të Boksit e Kosovës, Bordi i FBOXK-se, në mbledhjen e vet të mbajtur më 18.06.2022 miratoi këtë:

## **REGULLORE PËR SISTEMIN E GARAVE**

**PRISHTINË**

## I. PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë Rregullore më saktësisht caktohet sistemi i garave të boksit për të gjitha kategoritë e boksierve, mënyra e garimit në kampionatin ekipor dhe kampionatet/turnetë individuale të Kosovës.

Neni 2.

Garat të cilat parashikojnë pjesëmarrjen e publikut konsiderohen gara publike. Garat publike mund të jenë zyrtare dhe jozyrtare.

Neni 3.

Të gjitha garat e parapara nga kjo Rregullore janë zyrtare dhe e përbëjnë bazën për kategorizimin e klubeve të boksit dhe të anëtarëve të tyre.

Neni 4.

Gara jo zyrtare konsiderohen garat që nuk janë pjesë e kësaj Rregulloreje, takimet miqësore dhe ato stërvitore, si dhe paraqitjet në garat me karakter argëtues dhe propagandistik.

Neni 5.

Garat mund të jenë të tipit të hapur apo të mbyllur.

Në garat e tipit të hapur të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjitha klubet e regjistruara në FBOXK.

Në garat e tipit të mbyllur të drejtë pjesëmarrjeje kanë boksieret e klubeve të cilet janë të ftuar nga organizatori i gares.

Neni 6.

Është e drejtë dhe detyrë e klubeve dhe boksierëve që rregullisht të marrin pjesë në gara.

Neni 7.

Para fillimit të çdo viti garues përpilohet kalendari i garave. Me kalendarin e garave vërtetohet vendi dhe koha e mbajtjes së garave që parashihen nga kjo Rregullore, paraqitjet e përzgjedhjes, si dhe mbajtja e turneve përkujtimor dhe propagandues, të cilët Bordi ekzekutiv i vlerëson si të rëndësishëm për zhvillimin dhe popullarizimin e boksit. Secili klub i boksit e ka obligim të organizoj dy turne brenda vitit dhe të beje paraqitjen e dates së mbajtjes dhe emrin e turneut.

Propozimi i kalendarit të garave duhet të jetë gati çdo vit para 01 shkurtit, Klubet, anëtarë të FBOXK-së duhet ta marrin kalendarin më së voni deri më 22 shkurt të vitit rrjedhës.

## II LLOJET E GARAVE

Neni 8.

Garat e boksit në Kosovë ndahen sipas kategorisë, nivelit dhe gjinisë.

a) Sipas kategorise

Neni 9.

Kategoritë e garave mbështeten në moshën e garuesve. Garat zyrtare në FBOXK mbahen sipas kategorive:

- Seniorë dhe Seniore,
- U18 të rinjë/te reja
- U16 Juniorë/Junior
- U14 Kadetë dhe Kadete..

Neni 10.

Në kategoritë seniorëve dhe senioreve, në gara, mund të paraqiten të gjithë anëtarët e regjistruar në FboxK.

Neni 11.

Në kategorinë U18, në gara mund të paraqiten të gjithë anëtarët e regjistruar në FBOXK, të cilët deri në fillim të vitit kalendarik (01 janar) nuk i kanë mbushur 19 vjet.

Neni 12. Në kategoritë e juniorëve dhe juniorëve në garat mund të paraqiten të gjithë anëtarët e regjistruar në FBOXK, të cilët deri në fillim të vitit kalendarik (01 janar) nuk i kanë mbushur 17 vjet.

Neni 13. Kategorinë e kadetëve dhe kadeteve (shkollar) e përbëjnë garuesit të cilët deri në fillim të vitit kalendarik (01 janar) nuk i kanë mbushur 15 vjet.

b) Sipas niveleve

Neni 14.

Garat zyrtare te boksit në Kosovë janë të ndara në këto nivele:

I Turne boksi

II Kampionati individual për të gjitha grupmoshat

III Garat ndërkombëtare

## III. E DREJTA PËR PJESËMARRJE NË GARË

Neni 15.

Në gara, nga kjo Rregullore, mund të marrin pjesë të gjitha klubet e regjistruara në FboxK. Në garat individuale, mund të paraqiten boksieret që janë shtetas të Kosovës të regjistruar në FboxK, boksieret shtetas të Kosovës, të cilët me lejen e FboxK-së janë të regjistruar në klubet e huaja, të cilët sipas rregullave të IBA-se mund të paraqiten për përzgjedhjen e Kosovës. Përrjashtimisht, me ftesën e përzgjedhësit të përfaqësueses, në garat vetjake mund të paraqiten boksieret dhe kanë të drejtë të paraqiten për përzgjedhjen e Kosovës.

Neni 16.

Një garues mund të jetë i regjistruar vetëm për një klub dhe lejohet paraqitja vetëm në klubin e ri për të cilin është regjistruar. Në një ndeshje për një klub mund të paraqitet vetëm një garues.

## IV. GARAT

Neni 17.

Në të gjitha garat e FBOXK-së zbatohen rregullat e boksit të vërtetuara sipas IBA-së. Organizimi i të gjitha garave në FBOXK bazohet në Rregulloren për organizimin e garave të FBOXK -së. Organizimi i garave ndërkombëtare në Kosovë bazohet në rregullat e IBA-së dhe EUBC-së për gara ndërkombëtare.

Neni 18.

Ne kampionatin individual duelet zhvillohen ne duele eleminuese,te teten e finales,qerekfinale,gjysem finale dhe finalen varet prej paraqijes se numrit te boksierve

Neni 19.

Garat ne turnet vendore dhe nderkombetare zhvillohen ne duele qerekfinale,gjysem finale dhe finale.

## V. SHORTI

Shortin për garat i propozon Bordi i të FboxK-së pas propozimit te Komisionit te garave, ne kuvendin e FboxK,sipas rregullores te IBA-së i cili i miraton ato.

Neni 20.

Shorti i tërhequr njëherë, sipas rregullit, nuk mund të ndërrohet, përjashtim bëjnë:

- Kur vërtetohet se është bërë gabim në tërheqjen e shortit,
- Me paraqitjen e vogel te boksierëve në garë atëherë behet shorti dirigjues

## VI. GARAT NE FORM TURNEU

Seniorët dhe senioret

Neni 21.

Garat i udhëheq komisioni i garave, të cilin e emëron Bordi i FBOXK-së.

Të gjitha harxhimet e organizimit dhe zhvillimit të garave ne forme turneut i bartin klubet

## VII. GARAT INDIVIDUALE

Kampionati i Kosovës

Neni 22.

Kampionati i Kosovës është i tipit të hapur. Mund të marrin pjesë boksieret e të gjitha klubeve te regjistruara ne FBOXK.

Neni 23.

Në kampionatin Individual te Kosovës garat zhvillohen në këto disiplina:

- Meshkujt –individualisht
- Femrat – individualisht

Neni 24.

Garat zhvillohen me sistem eliminimi.

## IX. PËRZGJEDHJA (REPREZENTACIONI)

Neni 25.

Të përzgjedhurit e boksit të Kosovës përfaqësojnë, si individë apo si ekip të Kosovës, FBOXK-në, sportin në tërësi dhe Kosovën në garat ndërkombëtare.

Për ekipin e përzgjedhjes mund të paraqiten boksieret, shtetas të Kosovës të regjistruar në klubet e Kosovës apo jashtë kufijve të saj.

Caktimi i të përzgjedhurve për tu paraqitur në përzgjedhjen e Kosovës ose në garat vetjake ndërkombëtare është në kompetencë të përzgjedhsit.

## X. DISPOZITA PËRMBYLLËSE

Neni 26.

Me garat e boksit të vërtetuara me këtë Rregullore drejtpërdrejt udhëheqë Komisioni i Garave i FboxK-së. Komisioni i garave punën e tij e mbështet në Rregulloren për punën e Komisionit të Garave.

Neni 27.

Bordi i FboxK-së mund të vendosë që disa gara të organizohen ndryshe nga ajo që është e paraparë me këtë Rregullore.

Neni 28.

Kjo Rregullore ndryshohet dhe plotësohet sipas mënyrës së paraparë për nxjerrjen e tij. Interpretimin e kësaj Rregulloreje e bën Bordi i FBOXK-së.

Neni 29.

Këtë rregullore e harton dhe e miraton Bordi i FBOXK-së ne mbledhjen e mbajtur me 18.06.2022

Kjo rregullore hyn ne fuqi ,duke filluar nga data e miratimit.

Kryetari i FboxK-së  
Enver Krasniqi



Prishtinë më  
18.06.2022